

## EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

### Konkurs Ekspert afatshkurtër për TIK në Projektin e mbështetur nga BE “Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit”

Punëdhënësi:	Agjencia për Integrim Europian dhe Zhvillim Ekonomik (AEI)
Lokacioni:	Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Lloji:	Ekspert lokal afatshkurtër
Fillimi i prkishëm:	Janar 2022
Kohëzgjatja e pritshme:	20 ditë pune, Janar 2022 – Shkurt 2022

#### HISTORIA

Eksperti afatshkurtër do të punojë si pjesë e ekipit zbatues për projektin e financuar nga granti i Bashkimit Evropian “Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit” në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Projekti zbatohet nga një partneritet ndërkombëtar me përvojë i udhëhequr nga Agjencia për Integrim Europian dhe Zhvillim Ekonomik GmbH dhe tre bashkë-aplikantë – Ministria e Drejtësisë dhe Administratës e Republikës së Kroacisë, Ministria e Brendshme e Republikës së Austrisë dhe Instituti Ludwig Boltzmann i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut. Objektivi i përgjithshëm i projektit është të forcojë sundimin e ligjit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Puna do të realizohet në kuadër të Komponentit 3 - Përmirësimi i parandalimit dhe lufta kundër korrupsionit. Një nga rezultatet e pritura në këtë komponent është përmirësimi i zbatimit të ligjit për lobimin dhe kufizimet e dhuratave. Një aktivitet në kuadër të këtij rezultati i dedikohet zhvillimit të mjeteve të TIK-ut në mbështetje të Ligjit për lobim.

#### ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Eksperti afatshkurtër për TIK do të zhvillojë një vegël për regjistrim në ueb, ndryshimet në regjistrim dhe çregjistrim, si dhe një regjistër publik dhe një “lidhje ndërmjet regjistrimit dhe regjistrit”. Për më tepër, një sistem me flamur të kuq do të zhvillohet bazuar në informacionin e ofruar nga stafi i KPLK.

Eksperti afatshkurtër për TIK-do t'i raportojë drejtpërdrejt Liderit të komponentit për Komponentin 3 dhe ekspertit ndërkombëtar teknik të TIK-ut. Zhvillimi i mjeteve të TIK-ut duhet të sinkronizohet me zhvillimin e regjistrave të tjerë ekzistues në KPLK ose atyre në proces të zhvillimit. Kjo do të mundësojë një dizajn të ngjashëm dhe do të sigurojë mjete miqësore për përdoruesit për stafin e KPLK që punon me disa regjistra.

## EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

Eksperti do të mbajë takime javore. Qëllimi i këtyre takimeve është të përcjellë nga afër punën e ekspertit dhe të qëndrojë i informuar për çdo çështje që duhet të adresohet nga KPLK.

### REZULTATET E PRITURA

Eksperti afatshkurtër për TIK, në fazën e parë, do të zhvillojë një version testues të veglave për regjistrim, ndryshime në aplikacion dhe çregjistrim. Ky version do të testohet nga institucionet pilot dhe KPLK. Në fazën e dytë, krahas finalizimit të zhvillimit të versioneve testuese, do të bëhet versioni testues i regjistrimit dhe sistemi i flamurit të kuq. Më në fund aplikacioni i zhvilluar plotësisht do të testohet dhe finalizohet.

### KËRKESAT

#### Të përgjithshme

- Diplomë universitare (ose dhjetë vjetë përvojë relevante)
- 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale pas diplomimit
- Rrjedhshmëri në gjuhën angleze dhe maqedonase

#### Përvojë specifike profesionale

- Përvojë e dëshmuar e rëndësishme në analizën, përcaktimin dhe zbatimin e proceseve të biznesit
- Përvojë e dëshmuar e rëndësishme në analizën e sistemeve të TI
- Përvojë e dëshmuar e rëndësishme në ofrimin e specifikimeve të kërkesave për sistemet e TI-së që përfshijnë sistemet e TI-së me komponentë integruar
- Përvojë e dëshmuar e rëndësishme në zhvillimin e ueb aplikacioneve
- Përvojë e dëshmuar e rëndësishme në zhvillimin dhe/ose vendosjen e integritimit me sistemin e menaxhimit të dokumenteve Alfresco
- Përvojë e dëshmuar e rëndësishme në gjuhën programuese Java

### PËRPARËSITË

- Përvojë praktike në zbatimin e sistemeve të TI-së në institucionet publike

### DORËZIMI I APLIKACIONEVE

Aplikacionet duhet të dërgohen në [dragan.kovacevic@aei.at](mailto:dragan.kovacevic@aei.at) dhe [lana.andersson@rol.mk](mailto:lana.andersson@rol.mk) deri më 27.12.2021, duke shënuar "Short-term ICT Expert" në titullin e e-mail-it (subject) dhe duke përfshirë një CV të formatit Europass në gjuhën angleze dhe një letër motivuese. Aplikacionet e dërguara pas përfundimit të afatit ose aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në një listë më të ngushtë do të ftohen për një intervistë personale.

## EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

Eksperti i përzgjedhur do të nënshkruajë një kontratë për servis me projektin. Do të jetë përgjegjësia e tij/saj e vetme që të respektojë të gjitha kërkesat ligjore për vetëpunësim si dhe të mbulojë të gjitha taksat dhe tarifatat e parashikuara.

Eksperti nuk duhet të ketë pasur kontratë pune me administratën publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut së paku 6 muaj para punësimit.